



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
KUÇOVË

Nr. 4330 Prot

Kuçovë, më 31/12/2021

VENDIM

Nr. 83 Datë 23.12.2021

“PËR MIRATIMIN E VENDDEPOZITIMIT TË MBETJEVE INERTE”

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë _____.____.2021, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Transporteve, Shërbimeve Publike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Drejtoria Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore si dhe në zbatim të VKM Nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, si dhe ligjit Nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”,

VENDOSI:

1. Të miratojë venddepozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte për Bashkinë Kuçovë, me nr. Pasurie 46/15, me sipërfaqe 131600 m², me pronar Bashkia Kuçovë, me zonë kadastrale 2310, e cila ndodhet me adresë në lagjen nr.1, Blloku 11 Janari, rruga Beqir Ajazi, Bashkia Kuçovë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Transporteve, Shërbimeve Publike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Drejtoria Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore si dhe Inspektoriati i Policisë Bashkiake.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

Ky vendim u miratua me 16 vota Pro, - vota kundër dhe - vota abstenim.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
MIGENA BULLARI

